



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni Rregullator

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT
ZGJEDHOR DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të të nenit 20, pika 1, shkronja “gj”, nenit 115 e vijues të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Udhëzuesit të Punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO – Kryetare

Arens ÇELA – Anëtar

Dritan ÇAKA – Anëtar

Helga VUKAJ – Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar

Data: dd mm vvvv Nr: ...
Ora: hh:mm



Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

UDHËZUESI I PUNËS PËR KOMISIONET E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR DHE GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Ky udhëzues ka për qëllim të detajojë detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore.

Informacion mbi organizimin e Vendit të Numërimit të Votave, caktimin e grupeve të marrjes në dorëzim dhe detyrat e tyre, ngritjen e grupeve të numërimit të votave janë shpjeguar në materialin ndihmës për KZAZ.

Detyrat për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e Administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” janë të miratuara në vendimin nr. 23 datë 24.4.2023 të Komisionit Rregullator.

I. Rregulla të etikës

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave zbatojnë parimet për legjitimitet, transparencë, paanshmëri, profesionalizëm në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe aktet e KQZ-së. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Grupet e Numërimit të Votave, duhet të shmangin rrethanat e konfliktit të interesit duke e deklaruar atë. Rastet e shkeljes së dispozitave të Kodit Zgjedhore, i ngarkojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore me përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit.

Ndershmëria, korrektësia, përkushtimi, etika në komunikim janë tipare të rëndësishme për anëtarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe për anëtarin e Grupit të Numërimit të Votave. Puna korrekte e tyre do të sigurojë që vullneti i zgjedhësit/votuesit të materializohet në numërimin korrekt të çdo vote.

Në ushtrimin e detyrës, anëtarët e KZAZ dhe GNV, edhe pse janë propozime të një partie politike të caktuar, duhet të udhëhiqen nga interesi publik. Ata në ushtrimin e detyrave të tyre nuk duhet

t'u japin avantazh asnjë partie politike apo grupi interesi. Ata nuk duhet të manifestojnë përkatësinë dhe bindjen partiake e nuk duhet të mbajnë simbole apo shenja dalluese të tyre.

II. Rregulla në vendin e numërimit të votave

Në vendin e numërimit të votave, të gjithë personat që janë përfshirë në përbushjen e detyrave të tyre duhet t'i zbatojnë ato me përpikëri.

Kështu, grupet e marrjes në dorëzim duhet të kenë parasysh se në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë/kutive të votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV.

Grupet e numërimit të votave kryejnë, në mënyrë të pandërprerë, numërimin e të gjitha kutive të pranuar të rregullta nga ana e KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal.

KZAZ kujdeset, gjatë gjithë kohës, nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të teknologjisë mbështetëse të instaluar në VNV dhe në çdo tavolinë numërimi.

Pas marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor, KZAZ-ja dërgon elektronikisht në KQZ informacionin për Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, (nëse ka), apo kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore të cilat janë vlerësuar si "Kuti të parregullta", (nëse ka).

KZAZ merr masa dhe është përgjegjëse për personat të cilët lejohen të ndjekin procesin e numërimit të votave në VNV. KZAZ lejon, në VNV, anëtarët e grupit të numërimit të votave të caktuar me vendim të KZAZ, vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore dhe vëzhgues të tjerë të akredituar, kandidatët, përfaqësuesit e akredituar të medias, operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave, personelin teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave, stafin e KQZ, të pajisur me autorizim të posaçëm nga KQZ.

Përveç këtyre personave, KZAZ nuk lejon, në VNV, persona të tjerë. Në rast të pranisë së personave të tjerë, KZAZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

III. Radha e numërimit të votave

1. Numërimi fillon me votat për kryetarin e bashkisë dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin e bashkisë.
2. Numërimi i votave për këshillin e bashkisë fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për kryetarin e bashkisë.
3. Procedura dhe rregullat që ndiqen në procesin e numërimit të votave janë të njëjta si për numërimin e votave për kandidatët për kryetar bashkie ashtu edhe për subjektet zgjedhore.

IV. Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre

Duke qenë se në procesin e numërimit të votave , grupi i numërimit të votave, do të numërojë dhe do të vlerësojë votat është e nevojshme që ai të njohë llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të tyre. Fletët e votimit të vlerësuara nga Grupi i Numërimit, ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme.

Konsiderohen vota të vlefshme, fletët e votimit për kryetar bashkie në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie, apo fletët e votimit për këshillin e bashkisë, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore.

Konsiderohet votë e pavlefshme, fleta e votimit që nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja apo kur fletës së votimit i mungojnë dy vulat në pjesën e pasme të saj, përkatësisht vulën e KQV si dhe atë të kryetarit të KQV. Votë e pavlefshme është edhe kur në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës. Votë e pavlefshme është edhe kur në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit/ kandidatëve për kryetarë bashkie apo në fletën e votimit për këshillin e bashkisë, janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore. Gjithashtu, e pavlefshme konsiderohet vota edhe kur në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë është votuar për më shumë se një nga kandidatët për kryetar bashkie apo në fletën e votimit për këshillin e bashkisë është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore.

Kur zgjedhësi nuk ka votuar në fletën e votimit për asnjë nga subjektet zgjedhore/kandidatët për kryetarë bashkie apo edhe kur nuk është e qartë se për kë zgjedhësi ka votuar, fleta e votimit konsiderohet votë e pavlefshme. E tillë konsiderohet vota edhe nëse zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

Grupi i Numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit.

V. Veprime paraprake të KZAZ

Përpara se të fillojë procesi i numërimit, KZAZ kryen disa veprimet paraprake përmes të cilave sigurohet që gjithçka është gati për kryerjen e këtij procesi.

Si fillim KZAZ sigurohet se janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, dhe që të gjithë anëtarët e GNV-ve, kanë marrë trajnimin e nevojshëm.

KZAZ merr masat paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave duke u siguruar që Vendi i Numërimit të Votave është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave dhe që anëtarët e Grupeve të Numërimit janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat përkatëse të numërimit dhe janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave.

KZAZ verifikon që të pranishëm në VNV janë vetëm personat që janë të pajisur me dokumentacionin përkatës akreditim, autorizim apo vërtetim, sipas rastit, nga KQZ apo KZAZ. Ajo verifikon dokumentin e identifikimit të këtyre personave.

KZAZ sigurohet se është kryer mbyllja e kutive të posaçme dedikuar për fletët e votimit të hedhura gabim, sipas procedurave të mbylljes të kutive të votimit përcaktuar në Kodin Zgjedhor si dhe merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

Të gjitha veprimet paraprake të KZAZ shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

VI. PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

1. Vendimi për fillimin e procesit të numërimit të votave

Që procesi i numërimit të votave të fillojë duhet që KZAZ të ketë marrë në dorëzim KZAZ-ja të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të në juridiksionin e saj.

Pas kësaj, KZAZ merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave. Në vendimin për fillimin e numërimit të votave shënohet ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave. Ora e fillimit të procesit të numërimit të votave shënohet në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KZAZ-së.

Kutitë e votimit me fletët e votimit të pranuar si të rregullta në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe numërimit në VNV. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjitha kutive të pranuar të rregullta nga ana e KZAZ-së.

Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së, vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal të numërimit. Shkaqet argumentohen në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KZAZ-së, përfshirë dhe vendimin për rifillimin e numërimit.

2. Veprime paraprake të GNV për fillimin e procesit të numërimit të votave

Sekretari i Grupit të Numërimit nën kujdesin e një anëtari të ngarkuar nga KZAZ-ja:

- i. merr me radhë dhe sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një Qendre Votimi dhe e vendos atë pranë tavolinës së Grupit të Numërimit;
- ii. vendos/ngjit në tavolinën e përcaktuar nga KZAZ etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet;
- iii. merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV.

3. Hapja e kutisë së votimit

Për hapjen e kutisë së votimit, numëruesi i parë ka për të përmbushur një sërë detyrash. Së pari ai duhet të vendosë mbi tryezë kutinë me fletët e votimit dhe të ekspozojë atë në kamera për jo më pak se 2 sekonda në faqen anësore ku është vendosur etiketa me numrin e qendrës së votimit. Më pas, numëruesi i parë këput vulat me kodet e sigurisë si dhe nxjerr nga kutia e votimit “Procesverbalin e Mbylljes së Votimit”.

Pas kësaj, Grupi i numërimit të votave verifikon të dhënat e plotësuara në procesverbalin e mbylljes së votimit.

Numëruesi i parë dhe anëtarët e grupet të numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me “Procesverbalin e Vulosjes”. Ata shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Kur ka fletë votimi që i përkasin një organi tjetër ato lihen mënjane, pa bërë vlerësim. Në përfundim të numërimit të kutisë, këto fletë futen në zarfin me shënimin “Vota të hedhura gabim”, të ndara në zarfe të veçanta, sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur.

Nëse procesverbalit për mbylljen e votimit gjendet në kutinë me fletët e votimit dhe është plotësuar saktë, GNV fillon procedurat për numërimin e votave dhe vlerësimin e fletëve të votimit.

4. Numërimi i fletëve të votimit

Numëruesi i parë i GNV është personi që numëron fletët e votimit të shpalosura dhe të stivuara. Ai, në përfundim të numërimit, ia bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit të numërimit të votave si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Gjithashtu, numëruesi i parë verifikon shifrën e deklaruar duke përfshirë edhe me shifrën e votave të hedhura gabim me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në “Procesverbalin për mbylljen e votimit”. Numëruesi i parë rifillon numërimin e fletëve të votimit nëse shifra nuk përputhet, ose nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të GNV.

Kur konstatohen mospërputhje, atëherë GNV ose vëzhgues të subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, pa lëvizur nga vendi dhe duke ngritur dorën, njofton KZAZ. Derisa KZAZ të verifikojë rastin, procesi mbetet i pezulluar dhe GNV nuk kryen veprime të mëtejshme.

Sekretari i KZAZ pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit vetëm pasi KZAZ e ka konfirmuar atë. KZAZ merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ky vendim i njoftohet GNV.

5. Vlerësimi i fletëve të votimit nga faqja e pasme

Fletët e votimit të vlerësuara nga grupi i numërimit ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme dhe në fletë votimi të kontestuara.

GNV-ja, në tavolinën e numërimit, përcakton vendet e veçanta për fletët e votimit: të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara. Gjithashtu, GNV, në tavolinën e numërimit, në hapësirën e caktuar për votat e vlefshme, përcakton vende të veçanta për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për çdo kandidat/subjekt zgjedhor.

Numëruesi i parë, hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, i vendos një nga një fletët e votimit në kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme, jo më pak se 3 sekonda, në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe Vula e Kryetarit të KQV-së. Njëkohësisht, numëruesi i parë, gjatë këtij procesi, verifikon nëse fleta e votimit ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë, me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja, është vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e Kryetarit të KQV-së apo ka shënime, shenja apo nënshkrime, që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit. Gjatë këtij verifikimi, numëruesi i parë, shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit, të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme.

Në rast se ndonjë nga anëtarët e GNV ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakord me vlerësimin e mësipërm, numëruesi i parë e vendos fletën e votimit të

kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara (e cila do të vlerësohet përsëri nga GNV në momentin e rivlerësimit të votave) dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure, për fletën e votimit, vlerësuar e pavlefshme, nuk ka patur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së.

6. Vlerësimi i votave

Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga faqja e pasme.

Grupi i Numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit për subjektin zgjedhor. GNV-ja vlerëson shprehjen e vullnetit të votuesit, duke ju referuar modeleve ilustruese bashkëlidhur këtij udhëzuesi, por pa u kufizuar në to.

Numëruesi i parë, kur vlerëson se vota identifikon qëllimin e votuesit dhe se është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie/ subjekt zgjedhor dhe nuk është në rrethanat e pavlefshmërisë sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor, e propozon atë për vlerësim tek anëtarët e tjerë të GNV, se për cilin kandidat për kryetar bashkie/subjekt zgjedhor është hedhur vota.

Numëruesi i parë e vendos fletën e votimit në kamerën regjistruese, jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që shenja e cila tregon vullnetin e zgjedhësit, të shikohet qartësisht në monitor dhe bën vlerësimin e votës me zë të lartë. Në rast se numëruesi i parë nuk shfaq në kamerën regjistruese një fletë votimi dhe kur ky veprim kontestohet nga anëtarët e GNV-së ose vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, KZAZ detyron GNV të shfaqë në kamera fletën e votimit.

Në rast se anëtarët e Grupit të Numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim, janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për subjektin zgjedhor për të cilin është votuar. Numëruesi i parë merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedure.

7. Kontestimi dhe rivlerësimi i votës

Kontestimi i votës bëhet nga anëtarët e GNV ose çdo vëzhgues i subjekteve zgjedhore i tavolinës përkatëse të numërimit duke ngritur dorën e duke thënë “Nuk jam dakord”.

Numëruesi i parë, e vendos fletën e votimit të kontestuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Në përfundim të vlerësimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit, GNV rivlerëson fletët e votimit të kontestuara, por gjatë këtij procesi, fleta e votimit e kontestuar nuk shfaqet më në kamera. Gjatë procesit të rivlerësimit, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë të kontestojnë vlerësimin e votës dhe as të kërkojnë rishfaqjen e votave në monitor. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit.

Në rast se edhe pas rivlerësimit, mbeten ende fletë votimi të kontestuara, secili anëtar i GNV thërret KZAZ-në për vlerësimin e fletëve të votimit të kontestuara të asaj kutie. Vlerësimi i votës bëhet menjëherë nga KZAZ e cila merr vendimin për votë të vlefshme ose të pavlefshme. Sekretari i KZAZ shënon rezultatin e shpallur, nga KZAZ, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve i cili përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton Grupi i Numërimit të Votave. Për secilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon në pjesën e prapme të saj, qartë, arsyet e kontestimit. Numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV– në përkatëse, shënohet nga GNV në Procesverbalin përkatës miratuar me vendim të KQZ-së. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit për QV përkatëse, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “Fletë votimi të kontestuara”.

VII. Hapja e kutisë së materialeve të votimit

1. Rrethanat që çojnë në hapjen e kutisë së materialeve të votimit

Nëse në kutinë e votimit, procesverbali i mbylljes së Votimit mungon ose ky procesverbal nuk është plotësuar saktë, GNV apo vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, pa lëvizur nga vendi, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin, duke ngritur dorën.

Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV, derisa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ konfirmon mungesën e “Procesverbalit të Mbylljes së Votimit” në kutinë e votimit, pasaktësi ose parregullsi në plotësimin e tij, pasqyron faktet në “Procesverbalin e Konstatimit”. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në “Procesverbalin e Konstatimit”, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV.

Pas njohjes me vendimin e KZAZ-së, numëruesi i parë vendos kutinë me fletët e votimit, numërimi i së cilës është pezulluar, pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës së votimit përkatëse.

2. Veprimet me kutinë e materialeve të votimit

Kur është marrë vendimi i pezullimit, numëruesi i parë, në tavolinën e numërimit fillon veprimet me kutinë e materialeve të votimit të asaj qendre votimi, duke këputur vulat me kodet e sigurisë të saj.

GNV, si fillim, verifikon nëse në kutinë e materialeve të votimit ndodhet procesverbali për Mbylljen e Votimit, i plotësuar në mënyrë të rregullt.

a) Procesverbali për mbylljen e votimit gjendet në kutinë e materialeve të votimit

Nëse ky procesverbal gjendet në kutinë e materialeve të votimit, GNV ia dorëzon atë KZAZ, e cila pasqyron faktin në Procesverbalin e Konstatimit. Pas kësaj procedure, Sekretari i Grupit të Numërimit shënon numrat e kodeve për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit, në procesverbalin e Grupit të Numërimit që përdoret në këtë procedurë, e fut atë në kutinë e materialeve të votimit, dhe kopje të tij ia dorëzon KZAZ-së. Më pas numëruesi i parë i Grupit të Numërimit mbyll kutinë e materialeve të votimit me vulat me kode sigurie. Numëruesi i parë vendos kutinë e materialeve të votimit pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV-ja vazhdon me numërimin e votave sipas procedurave të rregullta për numërimin e tyre.

b) Procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet në kutinë e materialeve të votimit

Nëse procesverbali për mbylljen e votimit nuk gjendet as në kutinë e materialeve të votimit apo nuk është i plotësuar saktë në të gjitha rubrikat e tij, GNV ka për detyrë të verifikojë nëse në kuti ndodhen zarfi me fletët e votimit të papërdorura, zarfi me fletë votimi të dëmtuara, si dhe zarfi “vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”. Gjithashtu, GNV verifikon nëse në kuti ndodhen raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve, lista e zgjedhësve përfshirë edhe regjistrin e posaçëm, vulat, përkatësisht të KQV dhe të kryetarit të KQV, vulat me kodet e sigurisë të papërdorura, nëse ka, vulat me kodet e sigurisë të dëmtuara (nëse ka), Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, dokumentacioni shoqërues i fletëve të votimit me seritë përkatëse si dhe origjinalet e vendimeve të marra nga KQV. Numëruesi i parë, fillimisht krahason vulën e kryetarit të KQV-së me modelin krahasues dhe mendimin e tij ia bën të ditur anëtarëve të grupit të numërimit. Ai vijon me numërimin e fletëve të votimit të papërdorura, të dëmtuara.

Numëruesi i parë numëron edhe numrin e zgjedhësve që kanë votuar. Janë tre raste që numëruesi i parë duhet të ketë parasysh në përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar.

Rasti 1: Zgjedhësit janë identifikuar elektronikisht vetëm nga PEI

Në rastin kur zgjedhësit janë identifikuar vetëm nga PEI, numri i zgjedhësve merret nga raporti i mbylljes PEI.

Rasti 2: Zgjedhësit nuk janë identifikuar elektronikisht

Në rastin kur në qendrën e votimit është zbatuar procedura pa PEI me vendim të KQV-së, numëruesi i parë numëron numrin e zgjedhësve që kanë votuar, sipas nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve.

Rasti 3: Zgjedhësit janë identifikuar pjesërisht në mënyrë elektronike

Një rast tjetër është edhe kur një pjesë e procesit të votimit është zhvilluar përmes identifikimit elektronik nga pajisja PEI dhe më pas është ndërprerë identifikimi elektronik i zgjedhësve nga pajisja PEI dhe procesi me vendim të KQV ka vijuar pa PEI. Në këtë rast, pajisja nuk ka prodhuar raport me të dhëna. Në këto kushte, numëruesi i parë numëron zgjedhësit që kanë votuar sipas

nënshkrimeve që kanë bërë në listën e zgjedhësve, regjistrin e posaçëm të zgjedhësve dhe numrin e zgjedhësve që janë identifikuar nga PEI sipas numrit të dokumenteve fizikë të administruara në zarfin “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve”.

Në përmbushje të kësaj detyre të numëruesit të parë, pra për numrin e zgjedhësve që kanë votuar, numëruesi i parë në fund të numërimit ia bën të ditur shifrën anëtarëve të Grupit të Numërimit dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Nëse kërkohet rinumërim nga ndonjë prej anëtarëve të Grupit të Numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin. Gjithashtu ai hedh të dhënat për numrin total të fletëve të votimit të dorëzuara në KQV, bazuar në dokumentacionin shoqëruar të tyre si dhe hedh të dhënat në tabelën për qendrën e votimit. Në këtë tabelë, numëruesi i parë hedh të dhënat për numrin e zgjedhësve që kanë votuar, për fletët e votimit të papërdorura si dhe për fletët e votimit të dëmtuara.

Sekretari i Grupit të Numërimit, në “Procesverbalin e Mbylljes së Kutisë së Materialeve të Votimit” shënon numrat e kodeve dhe e fut atë në këtë kuti. Më pas numëruesi i parë i Grupit të Numërimit mbyll kutinë e Materialeve të Votimit me vulat me kode sigurie. Kopje të këtij procesverbali i dorëzohet KZAZ-së e cila shënon numrat e kodeve të vulave të sigurisë në “Librin e Protokollit”.

Kutia e materialeve të votimit vendoset nga numëruesi i parë pranë tavolinës së numërimit dhe ai merr kutinë e votimit të qendrës së votimit përkatëse, numërimi i së cilës ishte pezulluar. GNV vazhdon me numërimin e votave, sipas procedurave të rregullta për numërimin e votave.

VIII. Nxjerrja e Rezultatit të zgjedhjeve nga GNV për Qendrën e Votimit

Një nga detyrat e GNV është nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve për secilën qendër votimi që GNV ka numëruar. Për këtë grupi i numërimit të votave duhet të plotësojë tabelën e rezultateve së QV përkatëse. Para se grupi i numërimit të votave të plotësojë tabelën e rezultateve të QV duhet të kontrollojë dhe të sigurohet që numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti, të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme dhe votave të vlefshme si dhe të sigurohet që numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për subjektet zgjedhore në fletën e votimit.

1. Plotësimi i tabelës së rezultateve

Në përfundim të procedurave të numërimit dhe vlerësimit të votave për qendrën e votimit, numëruesi i parë së bashku me anëtarët e Grupit të Numërimit, plotësojnë tabelën e rezultateve të kësaj QV-je, për secilin nga kandidatët për kryetar bashkie dhe subjektet zgjedhore, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Numëruesi i Parë, së bashku me

anëtarët e tjerë të GNV-së, plotëson Tabelën e Rezultateve për Qendrën e Votimit, në të gjitha rubrikat e saj.

Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, janë të detyruar të nënshkruajnë tabelën e rezultateve të QV-së, votat e së cilës i kanë numëruar.

Në rast se anëtarët e GNV-së kanë kundërshtime për rezultatet e pasqyruara në tabelë, bëjnë shënimet në rubrikën përkatëse të tabelës së rezultateve të Grupit të Numërimit. Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave, janë të detyruar të nënshkruajnë tabelën e rezultateve të QV-së, votat e së cilës i kanë numëruar. Tabela e rezultateve, e plotësuar nga anëtarët e Grupit të Numërimit, duke përfshirë dhe kundërshtimet, nëse ka, shfaqet në kamera për jo më pak se 4 (katër) sekonda dhe i dorëzohet menjëherë dorazi KZAZ-së.

Po kështu, kundërshtime në lidhje me rezultatet e pasqyruara në tabelë mund të ketë edhe nga ndonjë nga vëzhguesit e tavolinës ku u krye numërimi. Këto kundërshtime shënohen menjëherë në Librin e Protokollit të KZAZ-së nga sekretari i saj.

Numëruesi i parë, menjëherë pas shfaqjes në monitor, dorëzon dorazi te sekretari i KZAZ, Tabelën e Rezultateve për QV-në, për kandidatët për kryetar bashkie/ kandidatët për këshillin bashkiak. Pas plotësimit të Tabelës së Rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja dërgon elektronikisht, nëpërmjet sistemit në KQZ, informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të asaj QV-je.

2. Dërgimi i rezultateve për çdo QV në KQZ

KZAZ dërgon në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin për rezultatet e zgjedhjeve menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GNV. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV. Tabela e rezultateve për QV-në, e printuar në 5 (pesë) kopje dhe e firmosur nga anëtarët e GNV, pas verifikimit të saktësisë u jepet, KZAZ-së kopja e parë me shenjë dalluese nga të tjerat, dhe anëtarëve të GNV kopjet e tjera. Anëtarëve të KZAZ si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë, u jepen fotokopje të vulosura nga sekretari i KZAZ me vulën e saj. Një kopje e tabelës së rezultatit të GNV, e vulosur me vulën e KZAZ, afishohet nga sekretari i KZAZ-së, në vendin e caktuar në VNV për këtë qëllim.

3. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit

Pas nxjerrjes së rezultatit dhe plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së nga GNV-ja, fletët e votimit futen në zarfe të ndara, sipas subjekteve zgjedhore. Votat e pavlefshme futen në zarfin me shënimin “vota të pavlefshme”, fletët e votimit të kontestuar janë grupuar më vete dhe futen në zarfin me shënimin “fletë votimi të kontestuar”.

Më pas të gjitha këto zarfe, përfshi zarfin me procesverbalin për Hapjen e Votimit, zarfin me Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, dhe zarfin me Procesverbalin e Vulosjes futen në kutinë e votimit e cila mbyllet me vula me kode sigurie të reja. Kopje e procesverbalit të vulosjes i dorëzohet sekretarit të KZAZ-së, i cili përgjigjet për administrimin e tyre si dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.

Grupi i Numërimit merr nga stiva e kutive të votimit kutitë me fletët e votimit të qendrës tjetër të votimit, vetëm pasi ka dërguar në vendin e caktuar brenda sallës së Vendit të Numërimit të Votave kutinë e përpunuar dhe i ka dorëzuar KZAZ-së tabelat e rezultateve të asaj Qendre Votimi.

4. Administrimi i votave “Të hedhura gabim” dhe numërimi i tyre

KZAZ-ja disponon dy kuti votimi, njëra për votat e hedhura gabim në kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë, dhe tjetra për votat e hedhura gabim në kutitë e votimit për këshillin e bashkisë. Hapja dhe mbyllja e këtyre dy kutive të votimit kryhet nga KZAZ sipas të njëjtave procedura që hapen dhe mbyllen kutitë e votimit.

Kur GNV përfundon së numëruari kutinë e fundit të saj, numëruesi i parë plotëson procesverbalin e konstatimit për votat e hedhura gabim, ku shënon numrin e votave të hedhura gabim për secilin organ që gjenden në secilin zarf të “votave të hedhura gabim” për çdo QV që ka numëruar GNV. Procesverbali i konstatimit ku janë shënuar numri i fletëve të hedhura gabim për çdo kuti votimi të numëruar, bashkë me zarfet përkatës të mbyllur “VOTA TË HEDHURA GABIM” i dorëzohen sekretarit të KZAZ-së.

Sekretari i KZAZ hap zarfet, shënon në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” numrin e QV-së së numëruar, organin për të cilin është votuar në atë kuti, që i korrespondon zarfi përkatës, numrin e fletëve të hedhura gabim të gjendura në secilin zarf, dhe hedh këto vota në kutinë e posaçme përkatëse, pa i hapur fletët e votimit.

Procesi i vlerësimit dhe numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara për secilin organ kryhet në përfundim të numërimit të votave për të gjitha kutitë e ZAZ-së. Për këtë, KZAZ-ja cakton menjëherë një prej Grupeve të Numërimit të Votave për kryerjen e vlerësimit dhe numërimit të votave të hedhura në kutitë e gabuara.

Grupi i numërimit, i caktuar për kryerjen e kësaj procedure, fillimisht merr nga sekretari i KZAZ-së procesverbalin e vulosjes me kodet e sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia përkatëse dhe verifikon përputhshmërinë e numrave të vulave të kodeve të sigurisë. Në rast se konstatohen mospërputhje, njoftohet menjëherë KZAZ-ja.

Në rast se nga verifikimi i GNV-së nuk rezultojnë mospërputhje të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat është mbyllur kutia përkatëse, atëherë GNV kryen, për aq sa është e mundur, procedurat për numërimin dhe vlerësimin e votave. Rezultati i secilës kuti me vota të hedhura gabim, hidhet në një tabelë rezultatesh të veçantë për votat e hedhura gabim, e miratuar me vendim të KQZ-së. Në këtë tabelë përcaktohet organi për të cilin janë hedhur votat.

IX. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve nga KZAZ

1. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për Kryetarin e Bashkisë

Menjëherë pas përfundimit të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit për kryetarin e bashkisë, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ, për kryetarin e bashkisë, në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo kandidati për çdo qendër votimi. Kjo tabelë përmbledhëse provizore e rezultateve të zgjedhjeve për kryetarin e bashkisë, nuk ka të përfshirë rezultatin e kutisë me vota për kryetarin, port ë hedhura gabim në kutinë e këshillit të bashkisë. Për këtë arsye, kjo tabelë nuk është përfundimtare dhe ka shënimin se rezultati nuk është përfundimtar.

Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike, në KQZ, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së. Në rast se KZAZ nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për kryetarin e bashkisë, çështja dërgohet për shqyrtim në KQZ, nga kryetari apo së paku dy anëtarë të KZAZ.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

2. Tablela Përmbledhëse e Rezultateve për këshillin e bashkisë

Pas numërimit të të gjitha kutive të votimit për këshillin e bashkisë, përfshirë dhe kutinë e posaçme me votat e hedhura gabim, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, miratohet me vendim nga KZAZ-ja. Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KQZ Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KQZ.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

3. Disa rregulla për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve

Për transmetimin dhe publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve përdoret aplikacioni kompjuterik i cili disponon disa kushte që duhet të mbahen parasysh nga GNV/KZAZ duke ndjekur procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 13.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për mbledhjen, administrimin, publikimin e rezultatit paraprak të zgjedhjeve dhe miratimin e modeleve të dokumenteve që përdoren për nxjerrjen e rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”

X. Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ

KZAZ është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të zgjedhjeve, materialeve zgjedhore. Menjëherë pas nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve në ZAZ, Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ dorëzojnë, me procesverbal, në KQZ, dokumentacionin e Zgjedhjeve e materialet zgjedhore, si dhe regjistrimin filmik të procesit të regjistrimit për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre dhe vlerësimit të çdo flete votimi, i cili ruhet në mënyrë elektronike. Asnjë procesverbal i KZAZ-së nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së.